REPUBLIKA E SHQIPËRISË

# MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

**MINISTRI**

Nr. 1539/17 prot. Tiranë, më 22/05/2020

**URDHËR**

**Nr. 339, datë 22.05.2020**

**"PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 193 DATË 20.03.2020 "PËRMBYLLJEN APO KUFIZIMIN E LËVIZJEVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË" TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të neneve 7,pika 4, dhe 15,tëligjit nr.15/2016,"Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeveinfektive",tëndryshuar, siedhe në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllimmbrojtjen e shëndetit të popullatës nga COVID-19,

**U R DH Ë R O J:**

Në Urdhrin Nr.193 datë 20.03.2020 "Për mbylljen apo kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar,bëhet ndryshimi si vijon:

1. Fjalia e fundit e pikës 3,ndryshohet si më poshtë:

   "Përjashtim nga ky rregull bëhet për pikat e shitjes së produkteve ushqimore me pakicë dhe farmacitë, të cilat ditën e shtunë, datë23Maj 2020,lejohen të ushtrojnë aktivitetin e tyre deri në orën 21:00."

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**

**Ogerta Manastirliu**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE - TIRANË

Adresa: Rruga e Kavajes, Nr.1001, Tirana, Albania. Tel: +355 42376178/ext 72120. www.shendetesia.gov.al